

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: *“Rehabilitim objekte ndërtimore faza II-të”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45210000-2**

PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe janë gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

VLERA E FONDIT LIMIT:

12.780.321 (*dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e njëzet e një*) lekë pa Tvsh

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar sipas manualit teknik per vitin 2024, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SPECIFIKIMI I TEKNIKE

OBJEKTI: RIKOSTRUKSION OBJEKTE NDERTIMORE FAZA II

PUNIME TE NDRYSHME NE PRISHJEJE

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjeshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementë çeliku dhe struktura betoni të forcuara do të ulen në tokë ose do të prihen për së gjati sipas gjerësisë dhe përmasave në mënyrë që të mos bien. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e prishjes duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira.

Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperience

c) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh dhe bombola frymëmarrjeje.

Prishja e çatisë

Shpërbërja e mbulesës së çatisë me tjegulla dhe të armaturës përkatëse prej druri, duke përfshirë trarët e mundshëm, dyshemenë ose paretet (ndërmjetëzat) me dërrasa, armaturën e madhe (e përbërë nga kapriatat, Trarët dhe pjesët e armaturës), pjesët intersektuese, kanalet e ulluqëve horizontale, ulluqët vertikale dhe kapset përkatëse metalike që rezultojnë nga heqja brenda ambientit të kantierit, si dhe zgjedhjen, pastrimin si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.

Prishja e mureve të tullës

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdo lloji mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj..), si dhe vënien mënjane dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

PUNIME MURATURE TULLE

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m3 mur tulle llaç I perzier. M=15 per ndertimin e parapeteve te demtuara, oxhaqeve sipas detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit . Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve rere guri, cemento,tullat, transportin. Llaci te prodhohet me betoniere ne objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri, te realizohet marka e kerkuare llacit.

NDERTIMI I ÇATISE

Ndertimi i çatise e matur horizontalisht do të realizohet me lende druri të shuarur e mbeshetur mbi trare të shuarur dhe të stazhionuar.

Lenda e drurit do të jetë e stazhionuar në mënyrë natyrale ose artificiale, inprejuar me vaj të djegur të pershtatshëm për lenden e drurit.

Makazet e çatise do të jenë 5x3 në çdo 33 cm

Permasat e mahive 10x6 cm largësia e tyre çdo 60 cm

Tjegullat do të jenë të reja betonike importi cilësi e parë, të gozhuara ose të lidhura duke përfshirë lidhjen e ulluqeve horizontale të çatise dhe kulmeve duke përdorur llac bastard M-25 të xingato, skelari ose çdo ndryshim tjetër të nevojshëm për ta përfunduar punën.

Në drejtim gjatësor do të vendosen kontroventime me permasa 10x6 cm.

Dalje në çati

Daljet në çati duhet të planifikohen për këto raste:

- Dalje për pastrimin e oxhakëve
- Dalje për heqjen e borës në raste se ajo e rëndon për së tepërmi çatinë dhe e rrezikon mbajtshmërinë e saj.
- Dalje për të bërë ndonjë riparim në çati.

Për objekte me çati duhet paraparë / planifikuar një dalje e sigurtë prej nënçatisë. Kjo dalje duhet të realizohet me anë të një dritareje me permasa 60 cm x 80 cm, e cila duhet të lidhet mirë me mbulesën e çatisë në mënyrë që të mos kemi rrjedhje të ujit.

Dalja në taracë ose në nënçati duhet të ketë dimensionin: max. 80 x 120 cm.

Me rëndësi është që kapaku i daljes në çati t'i plotësojë kërkesat e mbrojtjes kundër zjarrit si dhe kërkesat e koeficientit të ruajtjes të ngrohjes të tij

ULLUKE HORIZONTALE

Realizohen me pjerësi prej 1% për largimin e ujërave. Ulluqet horizontale prodhohen me llamarinë xingato me trashësi jo më të vogël se 0.8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm me të ulët se bordi i brendshëm të kompletuara me pjesë speciale në gryken e hyrjes. Ulluku horizontal i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me të xingato me hallka të forta të vena maksimumi në 70 cm.

ULLUKE VERTIKALE

Ulluket vertikale për shkarkimin e ujërave të çatise dhe të taraces së banjes

te përgatiten me llamarinë prej celiku të xinguara, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm, kurse ulluket horizontale prej xingato

kane diametër nga 8 deri 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe nga 30_60 m².

Ne çdo ulluk duhet të mbliidhen ujrat e një sipërfaqe catie ose tarrace jo më të mëdha se 60 m². Ulluket duhet të vendosen në pjesën jashtme të ndërtesës me anë të qaforeve perkatese prej çeliku të xinguar, të fiksuara çdo 2 m. Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m duhet të jetë PVC dhe të mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehen 90 grade.

BETON C – 16 /20

Në këtë cmim parashikohet teresia e shpenzimeve që nevojiten për realizimin e 1 m³ beton C – 16 / 20 për ndërtim brez betoni, betonin rreth objekteve duke respektuar projektin, në cmim futet dhe teresia e shpenzimeve për prodhimin ose blerjen e materialeve inerte, çimento, transportin, përgatitjen e betonit dhe hedhjen në veprë, ngjeshjen me vibrator, dhe trajtimin me ujë për realizimin e markes të kërkuar dhe dizarmimin e armatures. Në cmim futet dhe testet e bera për markën e betonit. Betoni të merret i gatshëm nga një nyjë e mekanizuar ose të prodhohet me betoniere në objekt sipas kushteve teknike dhe standartet, me rere guri + çakell, të realizohet marka e kërkuar e betonit. Në cmim futet dhe testet e bera për markën e betonit.

SUVATIM FASADE

Sprucim i mureve dhe strehve, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç bastard 0.03 m³; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shiritit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe të lëmuar me mistri e bërdaç, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

VEESHJE FASADE ME POLISTEROL KOMPAKT JESHIL t=5 cm +RJETE +SUVA

Veshja e fasades do të realizohet me polisterol kompakt me trashësi t=5 cm. Në cmim fute polisteroli, rrjeta dhe suvaja grafiato, skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund veshjes së fasades. Suvatimi i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m_25 dozim për m² rere e lare m³ 0.005 m³, llaç bastard m³ 0.03, çimento 400 7.7kg, ujë e aplikuar në baze të udhëzimeve të përgatitura në mure dhe të lëmuar me mistri e bërdaç, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo shërbim tjetër. Polisteroli të shoqërohet me certifikatën e çelësise.

LYERJE ME BOJE PLASTIKE

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet t'i paraqesë për aprovim Supervisorit, markën, cilësinë dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë. Të gjitha bojrat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzjerja e dy llojeve të ndryshme markash bojë gjatë procesit të punës. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe aprovimit të Supervisorit. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ

TAVAN RRJETE TELI+SUVA

Suvatimi i tavanit do te realizohet mbasi te jene bere te gjithë instalimet elektrike .

Perpara se te suvatohet do te vendoset rrjete teli dopjo te mberthyera me listela pishe pastaj do te behet suvatimi i tavaneve . Sprucimi i tavaneve do te behet me llac cemento te lenget per permiresimin e ngjitjes se suvase duke perfshire skelat e sherbimit dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar plotesisht suvatimin.

Suvatimi me drejtus i realizuar me nje shtrese me trashesi 2 cm llac bastard M-25 me permbajtrje rere e lare 0.005 m3 , llac gelqere M-1 :2 ,0.003 m3, cemento 400, 6.6 kg e uje i aplikuar me paravendosje te drejtuesve ne mure e lemuar me mistri e berdaf ,duke perfshire skelat e sherbimit si dhe cdo detyrim tjeter per ta perfunduar.

TRARE TAVANI TE SHARUAR

Ne kete cmim parashikohet teresia e shpenzimeve qe nevojiten per realizimin e 1 m2 tavan me trare te sharuar sipas (12x20)cm detajit teknik me gjeresi dhe lartesi sipas projektit . Ne cmim futet teresia e shpenzimeve per blerjen e materialeve lende pishe e stazhionuar, transportin si dhe vendosjen vendosjen ne veper sipas projektit.0 Lenda duhet te jete e stazhionuar dhe e lyer me bitum.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2024 sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te deklarojë se ka :

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marre së bashku gjatë pesë viteve të fundit të jetë jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarët e bashkimit të cilët kanë përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat.30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

1. NS 1 - A (Punime per prishjen e ndertimeve)
2. NP 3 - A (Rikonstruksion mirembjajte godinash civile e industriale)

**Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje licencat profesionale sipas zerave te preventivit qe ne baze te marreveshjes se bashkepunimit merr persiper te realizoje).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të liçencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë liçencë).*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohe n të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 3	Rikonstruksion mirembjajte godinash civile e industriale		A	
NS 1	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>		A	

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate ne formularin permbledhes te vetedeklarimit (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë të përfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete :

- **Inxhinier ndertimi (1)**

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetedeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimit për *“Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhënë nga një organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

Argumentimi: Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, “Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c. Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndertimi.

2.3.5 Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”, si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO

9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 16 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Murator** (2)
- **Suvaxhi** (3)
- **Saldator** (1)
- **Bojaxhinj** (2)
- **Karpentier** (4)

“Për punonjësit e mësipërm në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);
ose
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **punonjës shofer kamioni (1)**

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit autoriteti kontraktor I kërkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuar në mënyrë elektronike si më poshtë:

1. kontrata e punës (e vlefshme);

2. leje drejtimi kategoria C
3. *Certifikate Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor*

- **Punetore të thjeshte** (3)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

- **Murator**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit vendosje, punime betoni ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 2 murator të cilët do të realizojnë këto punime.

- **Suvaxhi**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit punime fasade ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 3 suvaxhi të cilët do të realizojnë këto punime.

- **Saldator**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit punime catie ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 1 saldator të cilët do të realizojnë këto punime.

- **Bojaxhinj**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit punime catie ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 2 karpentier të cilët do të realizojnë këto punime.

- **Karpentier**

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit punime catie ,kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 4 karpentier të cilët do të realizojnë këto punime.

- **punonjës shofer kamioni**

Eshte kerkuar 1 punonjes shofer kamioni per mjetin vetshkarkues per transportimin e materialeve te ndryshme.

- **Punetore të thjeshte**

Jane kerkuar dhe 3 punetore te thjeshte per te kryer punimet sipas preventivit dhe grafikut te percaktuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorë ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Shënimi-argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për

disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Një punësim mesatar i të paktën 16 punonjësish për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
Dhe
- b. **Listpagesat** e konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

Kriteret e percaktuara në piken 2.3.7. Eshtë kërkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 16 punonjësish për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” .

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 16 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohej që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Zberthimi

OBJEKTI: RIKOSTRUKSION OBJEKTE NDERTIMORE FAZA II						
Nr	AN	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njesi	Sasi	op/njesi	op/gjithes

				<i>a</i>		<i>ej</i>
A		RIKOSTRUKSION	PALLATE			
		SHEQERAS				
		RIKOSTRUKSION	PALLATE			
		SHEQERAS Nr 1				
		PUNIME ÇATIE				
1	An.	Prishje e ctise se vjeter	m2	180	0.50	90.00
2	2.37 1/a	Transport mbeturina deri 1 km	m3	20	0.10	2.00
3	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	85	0.37	31.45
4	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi	m2	180	2.30	414.00
5	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	30	1.10	33.00
6	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	53	1.30	68.90
7	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuver catie +oxhake	m2	16	1.60	25.60
8	2.64/ 1	Mur me tulle te plote llac i perzier M25(oxhak)	m3	0.5	11.00	5.50
9	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle deri ne 8 m(oxhaket)	m2	15	2.18	32.70
		SHUMA I				0.00
		PUNIME NE FASADE				0.00
1	2.350	Suva xokoli me granil e çimento te zak me spruco	m2	15	1.4	21.00
2	2,404 /1	Boje hidroplastike importi e cilesise se I-re	m2	300	1.47	441.00
3	2.358 /b	Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjet+suva	m2	300	4.00	1,200.00
4	3.205	Shtrese zhavori t=10cm	m2	35	0.026	0.91
5	2.262 /4	Struktura monolite betoni C-16/20 (rreth pallateve)	m3	3.5	8.60	30.10
		SHUMA II				0.00
		SHUMA I (I+II)				0.00
		RIKOSTRUKSION	PALLATE			0.00
		SHEQERAS Nr 2				0.00
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	An.	Prishje e ctise se vjeter	m2	193	0.50	96.50

2	2.37 1/a	Transport mbeturina deri 1 km	m3	20	0.10	2.00
3	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	85	0.37	31.45
4	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi	m2	193	2.30	443.90
5	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	30	1.10	33.00
6	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	53	1.30	68.90
7	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuvercatie +oxhake	m2	15	1.60	24.00
8	2,262 /4	Brez betoni C 16/20 per parapet t=10 cm	m3	3	8.60	25.80
9	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Φ6-10mm	ton	0.24	60.00	14.40
1 0	2.64/ 1	Mur me tulle te plote llac i perzier M25(oxhak)	m3	0.5	11.00	5.50
1 1	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle deri ne 8 m(oxhaket)	m2	15	2.18	32.70
		SHUMA I				0.00
		PUNIME NE FASADE				0.00
1	2.350	Suva xokoli me granil e çimento te zak me spruco	m2	16	1.4	22.40
2	2,404 /1	Boje hidroplastike importi e cilesise se I-re	m2	325	1.47	477.75
3	2.358 /b	Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjet+suva	m2	325	4	1,300.00
4	3.205	Shtrese zhavori t =10cm	m2	54	0.026	1.40
5	2.262 /4	Struktura monolite betoni C-16/20 (rreth pallateve)	m3	3.8	3.50	13.30
		SHUMA II				0.00
		SHUMA 2(I+II)				0.00
		RIKOSTRUKSION PALLATE SHEQERAS Nr 3				0.00
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	An.	Prishje e ctise se vjeter	m2	185	0.50	92.50
2	2.37 1/a	Transport mbeturina deri 1 km	m3	20	0.10	2.00
3	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	85	0.37	31.45

4	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi	m2	185	2.30	425.50
5	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	30	1.10	33.00
6	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	52	1.30	67.60
7	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuvercatie +oxhake	m2	16	1.60	25.60
8	2.64/ /1	Mur me tulle te plote llac i perzier M25(oxhak)	m3	0.5	11.00	5.50
9	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle deri ne 8 m(oxhaket)	m2	15	2.18	32.70
		SHUMA I				0.00
		PUNIME NE FASADE				0.00
1	2.350	Suva xokoli me granil e çimento te zak me spruco	m2	15	1.4	21.00
2	2,404 /1	Boje hidroplastike importi e cilesise se I-re	m2	325	1.47	477.75
3	2.358 /b	Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjet+suva	m2	325	4	1,300.00
4	3.205	Shtrese zhavori t=10cm	m2	54	0.026	1.40
5	2.262 /4	Struktura monolite betoni C-16/20 (rreth pallateve)	m3	3.8	3.50	13.30
		SHUMA II				0.00
		SHUMA 3 (I+II)				0.00
		PALLATE SHEQERAS SHUMA A(1-3)				0.00
B		RIKOSTRUKSION PALLATI FSHATI DRITHAS				0.00
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	2.373 /a	F.V Vetrato xhami I temperuar	m2	36	1.4	50.40
2	2.374	F.V Dritere metalike	m2	25	2.2	55.00
3	2.334	Suva e zakonshme fasada mur tulle lartesi mbi 8 m	m2	65	2.18	141.70
		SHUMA B				0.00
C		RIKOSTRUKSION PALLATI MALIQ				0.00
I		RIKOSTRUKSION PALLATI BLOKU Nr 2				0.00
I		PUNIME ÇATIE				0.00

3	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi(cati fallco)	m2	415	2.30	954.50
4	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	112	1.10	123.20
5	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	100	1.30	130.00
6	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuvercatie +oxhake	m2	30	1.60	48.00
7	2.64/ 1	Mur me tulle te plote h-8m llac i perzier M25(oxhak+ parapet)	m3	5	11.00	55.00
8	2,262 /4	Brez betoni C 16/20 per parapet	m3	5	3.50	17.50
9	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Φ 6-10mm	ton	0.4	60.00	24.00
9	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle deri ne 8 m(oxhaket)	m2	30	2.19	65.70
		SHUMA 1				0.00
2		RIKOSTRUKSION PALLATI 2 BLLOKU Nr 3				0.00
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	An.	Prishje e ctise se vjeter	m2	173	0.50	86.50
2	2.37 1/a	Transport mbeturina deri 1 km	m3	16	1.00	16.00
3	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	80	0.37	29.60
4	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi	m2	173	2.30	397.90
5	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	28	1.10	30.80
6	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	51	1.30	66.30
7	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuvercatie +oxhake	m2	2	1.60	3.20
		SHUMA 2				0.00
3		RIKOSTRUKSION PALLATE BLLOKU Nr 3				0.00
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	An.	Prishje e ctise se vjeter	m2	83	0.50	41.50
2	2.37 1/a	Transport mbeturina deri 1 km	m3	8	0.10	0.80

3	2.292	Trare tavani te sharuar	m2	85	0.37	31.45
4	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi	m2	83	2.30	190.90
5	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	14	1.10	15.40
6	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	22	1.30	28.60
7	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuver catie +oxhake	m2	1	1.60	1.60
8	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	20	4.7	94.00
		SHUMA 3				0.00
		PALLATE MALIQ SHUMA C (1-3)				0.00
D		RIKOSTRUKSION KINEMA VRESHTAS				0.00
		PUNIME ÇATIE				0.00
1	An.	Prishje e ctise se vjeter	m2	285	0.50	142.50
2	2.426	Prishje mur tulle(parapet)	m3	11	2.20	24.20
3	2.37 1/a	Transport mbeturina deri 1 km	m3	70	1.00	70.00
4	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla betoni importi	m2	285	2.30	655.50
5	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat seksion katror	ml	30	1.10	33.00
6	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat e panderprere	ml	57	1.30	74.10
7	2,203	Veshje kornize llamarine xingat(impjuver catie +oxhake	m2	15	1.60	24.00
8	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle deri ne 8 m	m2	18	2.18	39.24
		SHUMA D				11,280.56

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 11280
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore $11280 : 8 = 1410$ kemi 1410 punëtorë për një ditë pune
- 1410 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 64 punëtorë për një muaj punë.
- Sipas grafikut te punimeve kemi 16 punonjes per 4 muaj.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 7 ton deri 15 ton	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
2. Motobetoniere	<i>2cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
3. Kamioncine me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 1.5-3 ton	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
4. Autovinc	<i>1cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

(*Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve.Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.*)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme*
- 5. Certificate per leje transporti të leshuar nga Bashkia*

dhe për mjetet me qera,

- 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]*
- 6. Certificate per leje transporti të leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve të marra me qera nga operatorët ekonomikë bazuar në njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit të mallrave) ,mjetet nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak por për përdorim nga të tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

per mjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

1- motobetoniere 2 copë

Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni jane kerkuar 2 motobetoniere.

2- Kamioncinë 2 cope

Jane kërkuar 2 kamioncine për transportin e materialeve të ndryshme dhe të punonjësve.

3- Kamion vetshkarkues me mase maksimale te autorizuar sipas lejes se qarkullimit nga 7 ton deri 15 ton.

Eshte kërkuar 1 kamion vetshkarkues për transportin e materialeve të ndryshme

4-Auto vinc

Eshte kerkuar 1 autovinc per te ngritur tjegullat apo materialet e tjera sipas zerave te preventivit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.